



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:223369  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05722512

Ac.nr.704/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. L nga Komuna Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K. M avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K... me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F. Sh, për pagesën e pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3382/19 të datës 23.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e paditësit I. L nga Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3382/19 i datës 23.11.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit I. L, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura K..., me seli në Prishtinë që paditësit t'ia paguaj dy paga në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 731.00€x dy paga=1,462.00€, me kamatë vjetore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.00€, si e pa bazuar. Në pikën II., të dispozitivit secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi I. L ka parashtruar padi ndaj të paditurës K... në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj dy paga në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 731.00€ x 2 paga=1,462.00€, me kamatë vjetore prej 8%.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe atë: Kontratën e punës së paditësit me nr.10134/0 të datës 01.10.2016, kartelën e punëtorit me nr.10134 të lëshuar me datë 30.09.2019, librezë e punës me numër 260314, vendimin për shkëputjen e marrëdhënies së punës me nr.10134/0 të datës 20.04.2017, vendimin për pagesën e pagave me rastin e pensionimit me nr.2397 të datës 09.06.2017 si dhe listën e pagës së paditësit për muajin qershor 2017.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike: se paditësi ishte i punësuar tek e paditura në pozitën Inxhinier përgjegjës i ... deri me datë 09.06.2017 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare. E paditura me rastin e pensionimit paditësit ia ka paguar tri paga përcjellëse në shumën 2,193.00€. Paditësi i ka pasur gjithsej 25 vite, 4 muaj e 12 ditë përvojë pune. Paditësi në momentin e pensionimit ka realizuar pagën mujore në shumë 731.00€, ndërsa vitin jubilar prej 20 vite përvojë të punës i ka arritur në vitin 2012.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Lidhur me pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka llogaritur afatin e parashkrimit, kolegji gjen se paditësi ka kërkuar nga e paditura kompensimin në emër të shpërblimit jubilar, ndërsa e paditura e ka kundërshtuar këtë kërkesë me arsyetim se e njëjta është parashkruar. Kolegji në tërësi ka akceptuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se paditësi 20 vite përvojë pune i ka arritur në vitin 2012 dhe rrjedhimisht në kohën kur kjo është arritur, nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive pasi e njëjta ka hy në fuqi me 01.01.2015 dhe ka pasur shtrirje kohore të zbatimit deri me 31.12.2017. Kolegji ka miratuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se e drejta e paditësit për shpërblim jubilar, ka lindur në vitin 2012 dhe në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive. Lidhur me pretendimet se nga ana e gjykatave janë vendosur 4 raste identike kolegji gjen se rastet e bashkangjitura nuk përbëjnë raste të njëjta pasi në këto raste Kontrata Kolektive ka qenë në fuqi, në momentin e krijimit të të drejtës së paditësit. Është vlerësimi i Kolegjit të Gjykatës së Apelit se, gjykata e shkallës së parë me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, me të drejtë është bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës. Këtë vlerësim të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e mbështet edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë dhe vlerëson se në rastin konkret bëhet fjalë lidhur me arritjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin jubilar. Kjo për faktin se paditësi vitin jubilar e ka arritur në vitin 2012, ndërsa padinë e ka parashtruar me datë 07.10.2019. Në nenin 87 të Ligjit të Punës është përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tre vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.704/2022, me datë 22.05.2024

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj